



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:001398

Datë: 31.05.2022

Numri i dokumentit: 03078820

P.nr.05/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren e vetme gjykuese Mevlide Shabani, dhe sekretaren juridike Hyrije Sylejmani, në çështjen penale ndaj të akuzuarit M.B nga Gjilani, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së, me mbrojtësin e tij sipas autorizimit avokati Jeton Ibrahimimi nga Gjilani, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, me numër PP.II.nr.1763/2021, të datës 31.12.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 27.04.2022, mori dhe shpalli, ndërsa me datë 24.05.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari M.B, nga babai H. nëna R. e gjinisë M, i lindur me datë në Gjilan, i martuar, babai i katër fëmijëve, i pa punë, ka të kryer shkollën e lartë, i gjendjes së varfër ekonomike, me nr. personal, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse datë 09.06.2021, rreth orës 9:45min, në..., në Gjilan, i pandehuri M.B lehtë e lëndon tani të dëmtuarin SH.L nga Gjilani, në atë mënyrë të një mosëmarrëveshje dhe zënke të rastit që kishin pasur mes vete, i pandehuri fizikisht e sulmon të dëmtuarin, ashtu që fillimisht e kap për fyti, e godet dy herë me grushta në anën e majtë të fytyrës, duke i shkaktuar edhe një gërvishje afër syrit të majtë dhe me rastin e nxjerrjes nga vetura, i pandehuri kishte tentuar që ta godas me një kaqavidë që po e mbante në dorë, ndërsa i dëmtuari me qëllim të mbrojtjes, nga vetura e kishte nxjerrur një shkop druri ndërsa nga situata e krijuar intervenojnë disa persona që kishin qenë aty afër nuk i lejojnë që të njëjtin ta godasin njëri tjetrin me mjete të cilat i kishin në dorë, dhe pas kësaj i dëmuari për shkak të lëndimeve të pësuar detyrohet të kërkoj ndihmë mjekësore në Emergjencën e Spitalit Regjional të Gjilanit, ku pas kontrollimit mjekësor konstatohet se lëndimi i pësuar është i natyrës së lehtë.

-Me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së,

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, nenit 248 dhe 368 të KPP-së, të akuzuarin e lartcekur:

E GJYKON

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale brenda periudhës së verifikimit prej 1 (një) viti.

I dëmtuari SH.L për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohet i akuzuari i lart cekur që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 25 € (njëzet e pesë euro) shpenzimet e procedurës për ekspertiz mjeksore në shum prej 20 €, (njëzet euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

A R S Y E T I M

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 05.01.2022, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1763/2021, ndaj të akuzuarit M.B nga Gjilani, për shkak **të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së,**

Më datë 27.04.2022, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurorja e shtetit, Rozelida Manastiri, i akuzuari M.B me mbrojtësin i tij sipas autorizimit avokatin Jeton Ibrahimimi dhe i dëmtuari SH.L.

Në këtë seancë i akuzuari M.B, pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit si dhe konsultimeve me mbrojtësin e tij ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë. Ka shtuar se është penduar thellsisht për atë që ka ndodhur dhe i vie shumë keq, kërkon nga gjykata ti shqiptoj një dënim më të but pasiqë është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin si dhe është mbajtës i familjes prej 5 anëtarëve në gjendje të vështir ekonomike pa të ardhura personale, i premtonte gjykatës që nuk do të përsëris vepër penale të kësaj natyre apo natyre tjetër.

Mbrojtësi i tijë av. Jeton Ibrahimimi ka deklaruar se: pas pranimit të fajësis pa mëdyshje u vërtetua vepra penale për të cilin i vihet në barrë të mbrojturit tim edhe pse ky pranim është bërë me vullnetin e të akuzuarit, i propozoj gjykatës që ti merr parasysh si rrethanë lehtësuese gjendjen ekonomike, pranimin e fajësis në mënyrë vullnetare, pasiqë është rënë për her të parë ndesh me ligjin, si dhe premtimin e tij që në të ardhmen nuk do të përsëris vepër penale të kësaj natyre apo natyre tjetër.

I dëmtuari SH.L ka deklaruar se qëndron në tersi pran deklaratës së dhënë në polici dhe në prokurori, i bashkangjitet ndjekjes penale si dhe kërkesës pasurore juridike.

2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezente palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 të KPP-së. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza e po ashtu me rastin e pranimin të fajësisë nga ana e të pandehurit gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtarja e vetëme gjykuese vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri M.B, e ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 lidhur me paragrafin 1.nënparagrafi 1.4 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit ti shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale brenda periudhës së verifikimit prej 1 (një) viti, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 39 të KPRK-ës, gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69,70,71 dhe 72 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të pandehurin ka marrë faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale, se i njëjti është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tij, faktin se i njëjti është hera e par që ka rënë ndesh me ligjin dhe ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale. Me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit me kusht përveç tjerash gjykata pati parasysh edhe qëllimin e dënimit me kusht i cili konsiston në tërheqja e vërejtjes me kërcënimin si dhe është e nevojshme që të ndalojë kryesin të mos kryej vepra tjera penale.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit mund të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës, të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

5.Vendimi për kërkesën pasurore juridike.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, me qenë se i dëmtuari SH.L, ka deklaruar se paraqetë kërkesë pasurore juridike, gjykata duke u mbështetur në nenin 453 të KPP-së të njëjtën për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzon në kontest të rregullt juridiko civil.

6.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë ta paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 25€ (njëzet e pesë euro) shpenzimet e procedurës për ekspertiz mjeksore në shumën prej 20 €, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 30€ (tridhjetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm. Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.05/2022,
me datë 24.05.2022

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Mevlide Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjilan.